



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr.223/2024

Datë: 18.09.2024

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1, nenin 71, paragrafi 1, nën paragrafin 1, dhe 2, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të njoftimit, nga subjekti i të dhënave personale, ndaj Kolegjit "ISPE" Sh.P.K, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Urdhërohet**, Kolegji "ISPE" Sh.P.K, (në cilësinë e kontrolluesit), me NUI: 810800921, me adresë, Rr. Enver Maloku, nr.49, Bregu Diellit/Prishtinë, të ndaloj përpunimin e të dhënave personale (numrat e telefonave), të grumbulluara pa pëlqimin e subjektit, me qëllim të aplikimit të marketingut të drejtpërdrejtë.
2. **Urdhërohet**, kontrolluesi të shkatërroj përpunimin e të dhënave personale, të grumbulluara pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, me qëllim të realizimit të marketingut të drejtpërdrejtë.
3. **Obligohet** kontrolluesi, që aplikimin e marketingut të drejtpërdrejtë ta realizoj në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. **Obligohet** kontrolluesi, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i këtij vendimi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për zbatim të këtij vendimi dhe ta njoftojë Agjencinë për Informim dhe Privatësi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (në tekstin e më tutjeshëm Agjencia) ka pranuar njoftim nga subjekti i të dhënave personale, në të cilën ka shpreh shqetësimin se me dt. 27.03.2024 dhe 28.03.2024, pas vizitës që është bërë në Sh.f.m.u "Ismail Qemajli" në Prishtinë nga Kolegji "ISPE" Sh.P.K në cilësinë e kontrolluesit, kanë dërguar mesazhe (SMS) lidhur me aplikimin e marketingut të drejtpërdrejtë për të promovuar mundësinë e shkollimit në institucionin tuaj nga klasa e 9-12 të, në lidhje me atë se nga Kolegji "ISPE", ka pranuar mesazhe (sms), në numrin e tij/saj të telefonit +******, me qëllim të marketingut të drejtpërdrejt, pa pëlqimin

paraprak të tij/saj. Në njoftim ka shpjeguar se personat të caktuar nga Kolegji "ISPE" kanë formuluar lista, duke mbledhur numrat kontaktues të prindërve nga fëmijët e moshës 14 vjeçare, për qëllime përfitimi material, pa pëlqimin e subjekteve të të dhënave (në këtë rast, prindërve apo kujdestarëve të tyre).

Subjekti i të dhënave ka bashkëlidhur edhe provën me e mesazhit (sms) të pranuar nga kontrolluesi me përmbajtjen *"Ne nga Kolegji ISPE kemi berë një prezentim në shkollën 'Ismail Qemali', në të cilën fëmija juaja, vijon aktualisht mësimet, në lidhje me mundësin e shkollimit në Kolegjin ISPE nga klas 10 deri në klasën e 12. Nese keni interes për të ju njoftuar më shumë sa i përket mundësive të shkollimit qe ne ofrojmë në katër drejtimet e licencuara dhe të akredituara, drejtimet të cilat janë: 1. Bashkëpunëtor Profesional i infermërisë, 2. Teknik Dentarë, 3. Teknik i farmacisë dhe 4. Asistentë Fizioterapisë. Ateherë ne me kënaqësi mund të caktojmë një termin për të iu informuar më shumë për kushtet dhe mundësit e shkollimit të fëmisë suaj në Kolegjin ISPE. Gjitha të mirat! Kolegji ISPE.*

Andaj bazuar në nenin 68 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia më datë 08.04.2024, përmes postës elektronike, fillimisht ka kërkuar nga ana e Kolegjit "ISPE" Sh.P.K, (në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale), në kuadër të shqyrtimit të rastit, të informohen se cili është qëllimi i dërgimit të mesazheve promovuese, si janë grumbulluar të dhënat e personale (numrat e telefoni) e prindërve të nxënësve si dhe a keni pasur pëlqimin paraprak për dërgimin e mesazheve promovuese (marketingut të drejtpërdrejtë).

Më datë 11.04.2024, Agjencia ka pranuar një shkresë përmes postës elektronike nga kontrolluesi i të dhënave, ku ka njoftuar Agjencinë se: *"Në kuadër të aktiviteteve rreth edukimit dhe orientimit në karrierë, Kolegji ISPE organizon prezantime në institucionet arsimore por jo vetëm me qëllim që të prezantohen mundësit e shkollimit në Kolegjin ISPE, përkatësisht sesi mundësit (drejtimet) që ofron Kolegji ISPE mund të ndihmojnë në zhvillimin e karrierës së nxënësve. Listat me emrat dhe mbiemra të nxënësve, prezentë në prezentimet e Kolegjit ISPE në Shkollën 'Ismail Qemali' kanë qenë të shënuara me shkrim dore, gjithashtu edhe numrat respektivë të telefonave të shënuar me shkrim dore nga vetë pjesëmarrësit prezent. Mesazhet e dërguara nuk kanë të bëjnë asgjë me promovimin e Kolegjit ISPE ato janë mesazhe me të cilat pyeten bartësit e numrave, nëse ata dëshirojnë të informohen më shumë për mundësit e shkollimit në Kolegjin ISPE. Numrat e telefonave të shënuara në listat e pjesëmarrësve prezentë janë të shënuar nga ana e vetë pjesëmarrësve prezent. Të gjithë pjesëmarrësit në prezantime pyeten disa herë nëse ata dëshirojnë të kontaktohen në ndonjë numër telefoni andaj të gjithë ata që kanë shkruar me shkrim dore numrat përkatës në listat e shënuara.Nga më shumë 350 pjesëmarrës në prezentimet e Kolegjit ISPE në shkollën "Ismail Qemali" vetëm 180 nga ata kanë kërkuar që të kontaktohen të cilët kanë shënuar numrat e telefonave, në të cilët numra ata kanë kërkuar të kontaktohen nga ne.*

LMDhP, përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të LMDhP-së, me të dhëna personale nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekt i të dhënave"); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të

dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik. Në kuptimin e kësaj dispozite edhe numri i telefonit në bazë të të cilit mundet të identifikohet një person fizik, cilësohet e dhënë personale dhe përdorimi, në kuptimin e nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të LMDhP-së, përbën përpunim të të dhënave personale dhe si i tillë duhet të jetë i ligjshëm.

LMDhP-ja në nenin 4, parasheh parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale. Njëri ndër këta parime është parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës, në bazë të të cilit të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDhP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin. Në rastin konkret kriteret që duhet të zbatohet nga kontrolluesi, është marrja/dhënia e pëlqimit nga subjekti i të dhënave personale ashtu siç parashihet me LMDhP-në.

Neni 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.17, të LMDHP-së ka përcaktuar se: *“Pëlqimi i subjektit të të dhënave - nënkupton shprehje e lirë e vullnetit të dhënë lirisht, specifik, të informuar dhe të qartë të dëshirave të subjektit të të dhënave nëpërmjet të cilit ai ose ajo, me një deklaram ose me një veprim të qartë pohues, shprehë pëlqimin e tij/saj për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të”*. Për të qenë në përputhje me ligjin, pëlqimi ashtu edhe siç u tha më lartë duhet të jetë i dhënë lirshëm që nënkuptojmë se subjekti i të dhënave nuk është i detyruar të pranojë një kërkesë të tillë ose do të durojë pasoja negative nëse nuk pranon; të jetë specifik - të jetë i qartë për subjektin e të dhënave të shpjegojë qëllimin e saktë të dhënies së pëlqimit dhe nëse ka informacione të përgjithshme, ai duhet të jetë i ndarë nga ato dhe të jetë i informuar që nënkuptojmë se për të qenë pëlqimi i vlefshëm duhet që personi të informohet para se ai të jap pëlqimin, edhe pse koha apo momenti i marrjes së pëlqimit nuk është e përcaktuar, nga gjuha e dispozitave nënkuptohet që ai duhet të merret para se të fillojë përpunimi i të dhënave si dhe të përfshijë qartazi mjetin e komunikimit përmes të cilit dërgohet marketingu i drejtpërdrejtë. Pra, kontrolluesi që përpunon të dhëna personale për qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, duhet të sigurohen që pëlqimi të jetë qartë dhe i dallueshëm nga çështjet tjera, të jetë specifik për formën e komunikimit, si dhe të ketë dëshmi të pëlqimit.

Neni 73, paragrafi 1 i LMDhP-së, ka përcaktuar se “kontrolluesit e të dhënave mund të përdorin të dhënat personale që ata i kanë siguruar nga burimet publike të qasshme ose brenda kufijve të kryerjes së ligjshme të aktiviteteve për qëllime të ofrimit të mallrave, shërbimeve, punësimit ose kryerjes së përkohshme të punës përmes përdorimit të shërbimeve postare, thirrjeve telefonike, postës elektronike ose mënyrave tjera të komunikimit (marketingu i drejtpërdrejtë) në pajtim me dispozitat e ligjit, përveç nëse me ligjin përkatës është paraparë ndryshe. Sipas nenit 92, paragrafi 1, të Ligjit Nr.04/l-109 LKM-së, si ligj përkatës, shfrytëzimi i sistemeve automatike të thirrjeve pa intervenim të njeriut (makinat automatike të thirrjes), makinat e faksimilit (faksi) ose posta elektronike për qëllimet e marketingut të drejtpërdrejtë mund të lejohen vetëm për parapaguesit, të cilët më parë kanë dhënë pëlqimin.

Në kuptimin e LMDhP-së, marketingu i drejtpërdrejtë nënkupton dërgimin e informatave apo materialeve për promovim, adresuar një personi të identifikuar apo të identifikueshëm, përmes formave të ndryshme të komunikimit.

Andaj, duke u bazuar në provën e pranuar nga ankuesi, si dhe listat e pranuar nga kontrolluesi i të dhënave, është konstatuar se kontrolluesi nuk ka dëshmuar marrjen e pëlqimit të subjektit të të dhënave, për të pranuar marketing të drejtpërdrejtë, sipas kriterëve të një pëlqimi të vlefshëm si më sipër. Në këtë rast, ekzistenca e pëlqimit të vlefshëm është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Gjithashtu me rastin e aplikimit të drejtpërdrejtë (dërgimit të mesazhit) kontrolluesi, nuk ka i ka mundësuar pranuesit të drejtën e kundërshtimit të marketingut të drejtpërdrejtë.

Me këtë rast, kontrolluesi i të dhënave personale, me anë të ushtrimit të marketingut të drejtpërdrejtë në këtë mënyrë ka përpunuar të dhëna personale në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1, nenin 73, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëveprim me nenin 92, paragrafi 1, të Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas shqyrtimit të ankesave, vërtetimit të gjendjes faktike, provave të cekura më lartë, si dhe duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe kompetencat e dhëna me këtë ligj, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Dafina Duqi Koca

Zyrtare për inspektimit

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. “ISPE” Sh.P.K, - Kontrolluesit,
2. Arkivit të Agjencisë.